



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 20.02.2014
Nr. 0204-137

PËR: Nexhat Demaku, Kryetar i Komunës së Glllogocit
Naim Bazaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË GLLLOGOCIT Nr. 06-7091, pranuar me datën 19.02.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 06-7091 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit me datën 20.02.2014, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendimi Nr. 06-7091 për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme private të z. Nuredin Sali Krasniqi nga fshatin Negroc, për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 20.02.2014
Br. 0204-137

Za: Nexhat Demaku, Gradonačelnik Opštine Glogovac
Naim Bazaj, Predsedavajući Skupštine Opštine Glogovac

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE
GLOGOVAC, Br. 06-7091, primljena dana 19-02.2014

Poštovani,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu, Zakonu br. 03/L-025 o Zaštiti Sredine, dodatku XII Uredbe Vlade, Br. 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke Br-06-7091 usvojene dana 20.02.2014 od Skupštine Opštine Skenderaj , **POTVRDJUJE zakonitost** akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.

Pravni Akti koji proizvodi puni pravni efekat.

- Odluka br.06-7091, o odobrenju razmene nepokretne opštinske imovine ,sa nepokretnom privatnom imovinom g.Nurednin Sali Krasniqi u selu Negrovac,za izgradnju Centra Porođične Medicine.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera & Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Government of Kosovo

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministri i Lokale Self-Governance / Administration
 Ministry of Local Government Administration

Data / Datum: 19.02.2014

Shifra organizatore	Nr. i Lëvizës	Dhënia	Vlera
- VI -	024-213	3	



**REPUBLIKA E KOSOVËS
 KOMUNA E DRENASIT (GLLOGOC)**

Zyra e Kuvendit të Komunës
 Nr. 06-7091 dt: 19.02.2014

Në bazë të nenit 12 dhe 40.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr. 04/L-144 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt. 22 Nëntor 2012, nenit 34.6, i Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt: 13.02.2014 mori këtë:

VENDIM

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevojat e ndërtimit të Ambulancës familjare në fshatin Negroc, Komuna e Drenasit

I.

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Drenasit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevojat e ndërtimit të Ambulancës familjare në fshatin Negroc, Komuna e Drenasit**, Zona Kadastrale Negroc.

II.

LEJOHET këmbimi i një pjese të ngastrës kadastrale: P-962-0, zona kadastrale në Negroc, vendi I quajtur "KRGATE SHKOLLA" në sipërfaqe prej 0,05,00 ha, e në pronësi të Nuredin Sali Krasniqi nga Negroci e cila sipërfaqe do të përdoret për ndërtimin e Ambulancës Familjare në fshatin Negroc, Komuna e Drenasit.

Prona private e cekur më lartë do të këmbëhet me pronën komunale në zonën kadastrale Negroc në vlerë që do të caktohet nga zyra për vlerësimin e paluajtshmerive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave.

III.

Obligohet Kryetari i Komunës, që brenda pesë ditëve të punës, pas miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës së Drenasit të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin e pronës privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.

IV.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë parcelimin e ngastrave Komunale sipas raportit të vlerësimit dhe propozimit të DSHMS dhe pas lidhjes së kontratës mes Kryetarit të Komunës dhe pronarit privat të bëjë regjistrimin e pronës së këmbyer në Regjistrat Kadastral.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit, Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e K Drenas, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Drenas.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KRYESUESI I KUVENDIT
 NAIM BAZAJ

